



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:013069  
Datë: 07.10.2024  
Numri i dokumentit: 06261084

C.nr.339/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B.K. dhe F.G. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 879.27 euro, jashtë seancës, më datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësit në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, t’ia kompensojë shumën dhe atë:

1. Për periudhën kohore prej 01.10.2021- 31.12.2021, në shumë prej 42.93 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 520.22 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 563.15 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (12.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 879.27 euro, përkatësisht shuma prej 316.12 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja A.K. nga Prizreni në këtë gjykatë me datë 12.01.2024, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e

përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU “ZEF LUSH MARKU” në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore 01.10.2021 deri më 31.12.2022, paditëses në pagën prej 590.94 euro i takon shuma në lartësi prej 879.27 euro. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me datë 17.05.2024, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe të parashkruar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se vërtetimi me nr. reference 95/24 i datës 29.07.2024 për paditësin e lëshuar nga SHFMU “ZEF LUSH MARKU” në Prizren, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës që nga data 05.10.2021 dhe vazhdon të punoj, ndërsa paga bazë sipas listës së pagave nr.10-93277-622-0912 është 588 euro.

Po ashtu, nga njoftimit i MASHT-it të datës 11.12.2023 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është shuma prej 421.00 euro. Pasta, gjykata bazuar në Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e

*caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.*

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.10.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 42.93 euro ( $421 * 3.4\% = 14.31 * 3 = 42.93$  euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, mirëpo në kërkesën e paditëses është kërkuar në shkallë të inflacionit prej 11.55%, në këtë drejtim gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, *“vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*, andaj duke pasur parasysh kërkesën e paditësit dhe se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 520.22 euro ( $421 * 11.55\% = 48.62 * 10 = 486.2$  si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.02 sipas llogaritjes ( $48.62/30 = 1.62 * 21 \text{ ditë} = 34.02$ ) =  $486.2 + 34.02 = 520.22$  euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditëses kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 421.00 euro, duke u bazuar në njoftimin e MASHT-it të datës 11.12.2023, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses, e që është shuma prej 421.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësja në shumën prej 590.94 euro, pasi që këtë pagë paditësja e ka realizuar në vitin 2023 ashtu siç u vërtetua nga lista e pagave nr.10-93277-622-0912 (për vitin 2023) është në shumën prej 588 euro.

Gjykata po ashtu e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditëses nga data 21.11.2022, deri me datë 31.12.2022, kjo pasi që bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me numër

GJ.A-Su.A 214/2023, të datës 09.10.2023, në pikën III, është përcaktuar se: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur me datë 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri në datën 21.11.2022. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke ia refuzuar pjesën e kërkesë për periudhën 22.11.2022-31.12.2022si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësja në shumë prej 590.94 dhe asaj që paditësja e realizon e që është në shumë prej 421.00 euro, pra shuma e tërësishme e pabazuar në lartësi prej 316.12 euro.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës sa i përket parashkrimit të kërkesës mirëpo gjeti se është i pabazuar pasi që sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 21.07.2021, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e pagës mbi bazën e inflacionit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses nuk iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.10.2021 deri më datë 21.11..2022. Pasi që paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë me dt. 12.01.2024.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (12.01.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.339/2024, me datë 07.10.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.